



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 17.08.2022

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 11.08.2022, të parashtruar nga Operatori Ekonomik " DWH-KOSOVA" SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me instrument GPS ", Nr. i prokurimit- 632-22-7865-1-2-1, Nr. i brendshëm-632-22-073-121, nxjerr:

V E N D I M

1. **Refuzohet** si e pabazuar Kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik " DWH-KOSOVA" SH.P.K. e dt.11.08.2022, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me instrument GPS ", Nr. i prokurimit- 632-22-7865-1-2-1, Nr. i brendshëm-632-22-073-121, Dosjes së tenderit dhe Njoftimit për kontratë te AK –së, të datës 04.08.2022, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.
2. **Vërtetohet DOSJA E TENDERIT DHE NJOFTIMI PËR KONTRATË , i publikuar me datë: 04.08.2022;**
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdojë me aktivitetin e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe të publikohet në platformën elektronike të KRPP.

A r s y e t i m

Me dt.11.08.2022, Operatori Ekonomik " DWH-KOSOVA" SH.P.K ka parashtruar Kërkesë për rishqyrtim lidhur me aktivitetin prokurimit: "Furnizim me instrument GPS " , Nr. i prokurimit- 632-22-7865-1-2-1, Nr. i brendshëm-632-22-073-121.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 17.08.2022, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

- Sa i përket kërkesës se juaj për te ju dhënë data sheet ne te cilin ne jemi bazuar ne përgatitjen e specifikimeve teknike , kjo kërkesë përveç qe nuk ka ndonjë bazë ligjore paraqet ne vete edhe jo profesionalizmin e juaj për te përgatitur një ofertë teknike duke u bazuar ne kërkesat tona, pra ne bazë te kësaj ju dëshmoni se as nuk i keni njohurit bazike për përgatitje te specifikimeve teknike. Para se te ju japim definimin ligjore se si përgatiten specifikimet teknike ju bëjmë me dije se kërkesa e juaj për data sheet dhe pohimi i juaj se ne ju kemi përshtatur specifikimet teknike një prodhuesi te caktuar është vetëm një paragjykim sepse ju vet e pohoni se ju duhet burimi i përgatitjes se specifikacionit teknik, nëse nuk e dini burimin atëherë si mund te keni njohur rreth përshtatjes se specifikimit teknik një prodhuesi te caktuar.
- Sipas Ligjit për Prokurim Publik 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 saktësisht **neni 28 Specifikimet teknike, paragrafi 1 thotë:**

" Autoriteti kontraktues do ti parashtojë të gjitha specifikimet e detyrueshme teknike në dosjen e tenderit. Nëse aktiviteti përkatës i prokurimit kërkon publikimin e njoftimit të kontratës, autoriteti kontraktues (i) do të parashtojë specifikimet e tilla në njoftimin në fjalë, ose (ii) do të dërgojë një deklaratë të qartë që tregon se ku mund të merren specifikimet e tilla teknike. Kurdo që është e mundur këto specifikime teknike duhet të definohen në atë mënyre sa që të merren parasysh kriteret për mundësinë e qasjes së personave me aftësi të kufizuar apo dizajnimin për të gjithë shfrytëzuesit"

dhe paragrafi 2, i cili thotë:

" Autoriteti kontraktues do t'i përpilojë specifikimet teknike në atë mënyrë që ato të jenë në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik dhe tenderuesit. Autoriteti kontraktues është veçanërisht i ndaluar që të hartojë specifikime teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik"

- Bazuar ne këta dy paragrafë e sidomos paragrafi 2 tregon qartë se AK ka përpiluar specifikime teknike ne harmoni me qëllimin e prokurimit dhe pa ndonjë diskriminim te caktuar sepse as ju vetë si OE ankues nuk keni dhënë dëshmi se cilit model i përshtaten

këto specifikime apo për cilat arsyeje ju nuk mund te ofertoni, mirëpo vetëm keni paragjykuar përshtatjen e specifikimeve teknike dhe këtë e bazojmë ne faktin se ju ankoheni edhe për Windows 10 ku edhe kompania Leica qe ju përfaqëson ka dy modele te këtij lloji, prandaj te gjitha arsyetimet e juaja janë tendencioze dhe vetëm kanë për qëllim imponimin e zgjidhjes se juaj për neve si Autoritet Kontraktues. Konstatimin tonë për Windows 10 e mbështesim ne dëshmitë si ne vijim, referoju linqeve te mëposhtme:

- Kompania Leica qe ju përfaqësoni ka dy modele me Windows 10.
 - a) Controller Leica CS35 eshte me windows 10 linku nga website-I zyrtare I Leicas: <https://leica-geosystems.com/products/gnss-systems/controllers/leica-cs35>
 - b) Controller Leica CS30 po ashtu me Windows 10, linku nga website-I zyrtar I Leica: <https://leica-geosystems.com/products/total-stations/controllers/leica-cs30>

- Një kompani (prodhues) tjetër Trimble po ashtu ka Controller me Windows 10
 - a. <https://geospatial.trimble.com/products-and-solutions/trimble-tsc7>
 - b. <https://geospatial.trimble.com/products-and-solutions/trimble-tsc3>

- Një kompani (prodhues) tjetër Topcon po ashtu ka controller me Windows 10
 - a. <https://www.topconpositioning.com/field-software-and-controllers/field-controllers/fc-6000>

- Një kompani tjetër Sokkia (prodhues) po ashtu ka controller me Windows 10
 - a. https://eu.sokkia.com/sites/default/files/product/downloads/shc6000_broch_sok-1050_reva_team_en_us_lores.pdf

- Një kompani (prodhues) tjetër Carlson po ashtu ka controller me Windows 10
 - a. <https://www.carlsonsw.com/product/carlson-rt4>

--

2. Lidhur me IP, për këtë pyetje te juaj keni marr dhe një përgjigje nga eksperti I OSHP-se ne vendimin 228-19 te cilën përgjigje mund ta gjeni ne këtë link: <https://oshp.rks.gov.net/sq/ProcurementActivities/Download/9997a5da-9090-eb11-b597-005056ba09d5> përgjigja nga Eksperti:

Përgjigje në Pretendimin per specifikimet teknike nr.3

Lidhur me pretendimin e OE ankues, se IP-67 ne GPS dhe IP-68 ne Windows perben non-sens ne gjeodezi. Eksperti teknik thekson se eshte e vertete qe perben non-sens ne gjeodezi por perben sens ne aspektin e ruajtjes se GPS dhe terminalit nga kushtet e ndryshme atmosferike dhe per kete arsye nuk qendron ky pretendim.

Pra, nuk e shohim te arsyeshëm te merremi me shume ke ketë pike, pasi që ju i përsëritni me qellim këto pyetje vetëm e vetëm qe te shtyhet procedura!

Nga dëshmitë e mësipërme konstatojmë se kemi te bëjmë me specifikime teknike ne harmoni te plotë me nenin 28 te LPP-së saktësisht ne harmoni me te gjitha paragrafët përkatëse të këtij neni ku konstatojmë me përgjegjësi te plotë se këto specifikime teknike janë **të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik.**

Nga këto dëshmi shihet se Autoriteti kontraktues nuk ka përpiluar specifikimet teknike që i referohen një artikulli ose burimi të veçantë, ose një procesi të hollësishëm, ose ndonjë shenje dalluese, lloji ose origjine të veçantë ose ndonjë prodhimi sepse nga linqet e mësipërme shihet se kemi disa prodhues te tillë.

Në përgjithësi për ketë aktivitet te prokurimit deri ne ketë fazë janë respektuar parimet e ligjit për prokurim publik siç janë:

- **Ekonomiciteti dhe Efikasiteti**
- **Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi**

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**

Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit



Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit te Komunës;
Te gjitha palëve te interesuara;
Arkivit të Komunës